



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr.219/2019

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Kymete Kicaj kryesuese, Afijete Sada Gillogjani dhe Adnan Konushevcu, anëtarë, me pjesëmarrjen e zyrtares së lartë ligjore Antigona Murati, duke vendosur përkitazi me ankesën e Organizatës Joqeveritare BIRN dhe INTERNEWS KOSOVA, me seli në Prishtinë, paraqitur kundër koalicionit AAK/PSD, me seli në Prishtinë, për shkak të vendosjes së posterëve të kandidatit të tyre në afërsi të objekteve publike, për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës, që do të mbahen me datë 06.10.2019, në seancën e panelit të mbajtur me datë 05.10.2019, mori këtë:

VE N D I M

Refuzohet si e pabazuar ankesa Anr.219/2019 e datës 04.10.2019, e parashtruar nga Organizata Joqeveritare BIRN dhe INTERNEWS KOSOVA, ndaj koalicionit AAK/PSD.

A r s y e t i m

Me datën 04.10.2019, PZAP-i ka pranuar ankesë nga Organizata Joqeveritare BIRN dhe IKS, me të cilën pretendon se me datën 03.10.2019, rreth orës 16:01, janë parë disa materiale promovuse të kandidatit për deputet në radhët e kolaicionit AAK/PSD. Këto materiale paraqitësi i ankesës thekson se janë të vendosura në hyrje të shkollës “Fazli Graçevci” në Caravodic.

Sipas paraqitësit të ankesës vendosja e posterëve në hyrje të shkollave është në kundërshtim me rregullën zgjedhore Nr.13/2013, përkatësisht nenin 3.4, dhe se pavarësisht nëse Komuna i ka parapare si vende në të cilën mund të vendosen posterët, ato janë pranë shkollave, brenda perimetrit 100 metër, dhe janë në kundërshtim me ligjin dhe rregulloret.

Paraqitësi i ankesës në mbështetje të pretendimeve në ankesë, si dëshmi ka bashkangjitur fotografi të printuar.

PZAP-i, pasi që shqyrtoj ankesën vlerësoi se:

Ankesa është e pabazuar

Duke u nisur nga arsyet e theksuara me lartë, Paneli konstaton se nga ana e koalicionit AAK/PSD, nuk është bërë shkelja e nenit 33 pika (b) të LZP-së, pasi posterët e kandidateve nga subjekti politik PDK, janë vendosur në vendin e dedikuar për reklamim - vendosje të posterëve.

Ndërsa lidhur me pretendimet e paraqitësit të ankesës se posterët janë vendosur në hyrje të shkollës "Fazli Graçevci" në Caravodic, PZAP-i thekson se në këtë periudhë kohore këto veprime nuk janë në kundërshtim me dispozita ligjore. Veprimet e parashtruara në ankesë janë të ndaluara vetëm para fillimit të votimit dhe gjatë ditës së zgjedhjeve në qoftë se ajo shkollë gjatë ditës së zgjedhjeve shërben si Qendër e Votimit ku sipas nenit 85.1 të LZP-së, parashihet që 24 orë para fillimit të votimit të gjitha subjektet politike të cilat nuk kanë larguar materialet e fushatave të tyre zgjedhore të vendosura brenda dhe rreth cilido vendvotim ose qendre të votimit në rreze prej 100 metra, duhet të largohen nga anëtarët e KVV-ve, ose Menaxheri i QV-së, dhe se subjektet politike të cilat nuk i kanë larguar ose janë gjetur duke postuar do të raportohen në PZAP për shkelje të këtij ligji.

Periudha kohore për të cilën parashihet të aplikohet kjo dispozitë ligjore është 24 orë para votimit dhe gjatë ditës së votimit, kurse ankesa është parashtruar gjatë fushatës zgjedhore, Paneli erdhi në përfundim se janë të paqëndrueshme pretendimet e paraqitësit të ankesës, se këto veprime përbëjnë shkelje të rregullores 13/2013, nga subjekti politik PDK, pasi që posterët në fjalë janë vendosur në vendin e dedikuar për vendosjen e tyre, ashtu siç vërtetohet nga fotografit e ofruara nga pala ankuese që gjenden në shkresat e lëndës.

Nga arsyet e theksuar më lartë, duke bazuar nenin 118 par.1 të LZP-së, paneli vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia

Anr.219/2019 më datën 05.10.2019

Kryesuese e Panelit

Kymete Kicaj



Këshilla Juridike: Kundër këtij vendimi nuk lejohet ankesa sipas nenit 118 par. 4 të LZP-së.